



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës  
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture  
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

DATË/A:	17.01.2025
REFERENC-Ë:	24/3571/MMPHI
PËR/ZA/TO:	K.P.N.P. "Pro-Eng" Sh.p.k., Bazë e Betonit, Shillovë, Gjilan.
	Komisioni për Leje Mjedisore.
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Arkivës së MMPHI-së
NGA/OD/FROM:	Izedin Bytyqi, U.D. i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI.
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim për ndëprerje procedurës së Lejes Mjedisore.

Të nderuar/a,

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), ka shqyrtuar kërkesën për vazhdimin e Lejes Mjedisore të operatorit K.P.N.P. "Pro-Eng" Sh.p.k., për veprimtarinë: Bazë e Betonit, Shillovë, Gjilan.

MMPHI, pas shqyrtimit të kërkesës të lartpërmendur, një sërë takimesh dhe vizitës në teren, ka vendosur si në Vendimin e bashkëngjitur.

Me respekt!



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës*  
*Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture*  
*Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*

*Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary*

Nr.: 24/3571/MMPHI  
Datë: 17.01.2025

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019), Rregullores (QRK) Nr.13/2024 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenit 31 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, paragrafi 3 të nenit 10, të Udhëzimit Administrativ MMPHI Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, nxjerrë këtë:


## V E N D I M

1. Operatorit, K.P.N.P. "Pro-Eng" Sh.p.k. i ndërpritet **procedura administrative** për veprimtarinë: Bazë e Betonit në ngastren nr.300 dhe nr.300-2 zona kadastrale Shillovë, Gjilan.

## A r s y e t i m

Pas shqyrtimit të kërkesës për Leje Mjedisore për operatorin, K.P.N.P. "Pro-Eng" Sh.p.k., me nr.pot.24/3571/MMPHI, për veprimtarinë: Bazë e Betonit në ngastren kadastrale nr. 300 dhe nr. 300-2 zona kadastrale Shillovë, Gjilan, konstatohet që operatori nuk plotëson kriteret e parapara me Udhëzim Administrativ 04/2022/MMPHI, për vazhdimin e Lejes Mjedisore.

Faqe 2 nga 3



Operatori ka bashkangjitur dokumentet:

- Aplikacionin e plotësuar në pesë kopje fizike dhe një kopje elektronike (CD);
- Fletëpagesën, në bazë të Vendimit: Nr. 13/99, te dt. 30.09.2022, për përcaktimin e kriterëve dhe vlerat e tarifës për shërbimet lidhur me procedurat e shqyrtimit të kërkesave për leje mjedisore;
- Certifikatën e regjistrimit të biznesit-ARBK;
- Pëlqim Mjedisor me Nr. 11/1451/1-ZSP/174/11, te lëshuar me datë: 31.08.2011;

MMPHI, ka kontrolluar dokumentacionin dhe në përputhje me nenin 10 paragrafi 3 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr.04/2022, ka kërkuar nga operatori plotësim të dokumenteve si në vijim:

- Leja për aktivitet të veçantë nga KPMM.
- Leje ujore për shfrytëzim dhe
- Leje ujore për shkarkim.

Operatori nuk ka sjell dëshmi për plotësimin e dokumentacionit të cekur me lartë.

Andaj bazuar në të cekurat më lartë, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, **ndërpret procedurën administrative** në përputhje me nenin 10 paragrafi 3 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 04/2022.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi, në Gjykatën Themelore, në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi.



U.D. i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI-së

Vendimi i dërgohet:

- Parashtruesit të kërkesës;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Komunës- Gjilan;
- DMMU-së;
- Inspektoratit të MMPHI-së;
- Kabinetit të Ministrisë;
- Zyrës për komunikim me Publik të MMPHI-së;
- Arkivit të MMPHI-së